



Crna Gora / Mali i Zi
Opština Ulcinj
Komuna e Ulqinit
Kabinet Predsjednika
Kabineti i Kryetarit



Crna Gora - Mali i Zi
Opština Ulcinj - Komuna e Ulqinit

Opština - Priloga	05. 12. 2024	
Org. ed. / Njes. Org.	Boj. Numeri	Priloga - Rus. Kuv. / Vred. - Vlera
02-040/24-573/2		

Adresa: Bul. Skenderbega/Skenderbeu
85360 Ulcinj/Ulqin, Crna Gora/Mali i Zi
tel: +382 30 412 050
e-mail: kabinet@ul-gov.me

Br./Nr. 01-040/24-1777/2

Ulcinj/Ulqin, 05.12.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT- SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
Kryetares së Kuvendit/ Predsjednici Skupštine

KËTU/OVDJE

E nderuara/ Poštovna,

Në bazë nenit 58 paragrafi 1 alinea 2 Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 – Vendimi i GjK MZ i 85/2022 – përmirësimi i Vendimit GjK MZ) dhe nenit 65 të Statutit të Komunës ("Fleta zyrtare e MZ – Regloret komunale", br. 48/2019 i 5/2024), në shtojcë ju dërgojmë propozim Vendimin mbi kriteret, metodën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për promovimin e komunitetit të teknologjisë, informacionit dhe komunikimit (TIK) e përgaditur nga Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim të qëndrueshëm, që ta veni në rend të ditës në mledhjen e ardhëshme për ta votuar.

Na osnovu člana 58 stav 1 aline 2 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Službeni list CG", br. 2/2018, 34/2019, 38/2020, 50/2022, 84/2022 - Odluka US CG i 85/2022 - ispravka Odluke US CG) 65 Statuta Opštine ("Službeni list CG – Opštinski propisi", br. 48/2019 i 5/2024), u prilogu Vam dostavljamo, predlog Odluke o kriteriumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj ICT zajednicu, koju je pripremio Sekretariat za privredu i ekonomski razvoj, da bi je stavili u dnevni red u narednoj sjednici Skupštine radi usvajanja-glasanja.

Me rrespekt/ S poštovanjem,



Kryetari/Predsjednik
Gençi Nimanbegu

Në bazë të nenit 27 paragrafi 1 pika 6 e Ligjit për Vetëqeverisjen lokale ("FL. Zyrtare MZ", nr. 2/18 dhe 34/19) dhe nenit 31 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Ulqinit, Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në seancën e mbajtur me datë _____, miratoi

V E N D I M

mbi kriteret, metodën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për promovimin e komunitetit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky vendim përcakton kriteret, mënyrën dhe procedurën për shpërndarjen e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Ulqinit për promovimin e komunitetit TIK.

II – PËRDORUESIT E MJETEVE

Neni 2

Mjetet e buxhetore të përcaktuara për qëllimet e përmendura në nenin 1 nga buxheti vjetori i Komunës së Ulqinit ndahen për projektet e personave, institucioneve, kompanive dhe organizatave joqeveritare me seli në territorin e komunës së Ulqinit.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni planifikohen si linjë e veçantë buxhetore në buxhetin e Sekretariatit kompetent për fushën e sipërmarrjes.

III – THIRRJA PUBLIKE

Neni 3

Shpërndarja e mjeteve nga neni 2 i këtij Vendimi bëhet në bazë të thirrjes publike (në tekstin e mëtejme: thirrja), i cili shpallet nga Komisioni për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK. Thirrja mund të shpallet më së shumti tre herë në vit.

Në rast që mjetet e planifikuara nga buxheti i Komunës së Ulqinit për këtë qëllim nuk shpërndahen ose nuk shpërndahen plotësisht për projektet e dorëzuara, shpallet thirrja e re, jo më vonë se fundi i vitit buxhetor.

Neni 4

Thirrja publikohet në një gazetë ditore, në web faqen e Komunës së Ulqinit, transmetuesit publik lokal dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

Thirrja për shpërndarjen e fondeve është e hapur për 30 ditë nga dita e shpalljes së tij.

IV – KOMISIONI PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE

Neni 5

Procesi për shpërndarjen e mjeteve kryhet nga Komisioni për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), i cili emërohet nga Kryetari i Komunës me vendim të veçantë. Komisioni ka në përbërjen e tij një Kryetar dhe dy anëtarë.

Komisioni është përgjegjës për:

- Shpalljen e Thirrjes publike;
- Shqyrtimin dhe vlerësimin e vlefshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar dhe propozimeve të planit të biznesit sipas kriterëve të përcaktuar;
- Përgaditjen e propozimit për vendimin e shpërndarjes së mjeteve;
- Përgaditjen e kontratave me subjektet, projektet e të cilëve janë miratuar nga Komisioni
- Përgaditjen e raporteve për realizimin e mjeteve të shpërndara.

Kryetari i Komisionit emërohet nga rradhët e nënkryetarëve të komunës ose kryesisë së organeve të vetëqeverisjes lokale.

Anëtari i dytë i Komisionit është udhëheqësi i organit kompetent të vetëqeverisjes lokale për fushën e ekonomisë.

Anëtari i tretë i Komisionit emërohet nga shoqatat profesionale ose komuniteti akademik.

Organizatat ose personat nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në thirrjen publike nëse përfaqësuesi i tyre, ose vetë personi, emërohet si anëtar i Komisionit.

Mandati i Komisionit është dy vjeçar.

Kompensimi për punën e tyre në Komision nuk u takon anëtarëve të punësuar në vetëqeverisjen lokale. Anëtarët e tjerë kanë një tarifë të barabartë me tarifën e këshilltarit për çdo ftesë publike.

Detyrat profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Komisionit i kryen Sekretari i Komisionit i cili emërohet nga sekretariati kompetent.

V – PËRFUNDIMI I MANDATIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT

Neni 6

Mandati i anëtarit të Komisionit përfundon para përfundimit të mandatit për të cilin është emëruar, në rast se:

- 1) paraqet dorëheqjen, për të cilin e njofton Kryetarin e Komisionit dhe subjektet që e kanë propozuar;
- 2) me vendim të formës së prerë i hiqet aftësia për punë;
- 3) me vendim gjyqësor të formës së prerë është dënuar me burgim të pakushtëzuar prej së paku 6 muaj, dhe
- 4) në rast shkarkimi.

Neni 7

Kryetari i komunës e shkarkon anëtarin e Komisionit në rast se:

- 1) konstatohet se gjatë emërimit ka dhënë informacione të pasakta për veten e tij ose nuk ka dhënë informacionet e duhura dhe ka treguar për rrethana që kanë ndikuar në emërimin për anëtar të Komisionit;
- 2) nuk e kryen funksionin e anëtarit të Komisionit për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj;
- 3) kryen funksionin e tij në mënyrë të pakujdesshme dhe joprofesionale.

Neni 8

Procedurën për shkarkimin e një anëtarit të Komisionit e fillon Kryetari i Komunës me iniciativë të kryetarit të Komisionit.

Në procedurën e shkarkimit, anëtarit të Komisionit ka të drejtë të deklarojë arsyet e shkarkimit të tij. Kryetari i Komunës merr vendimin për shkarkimin e anëtarit të Komisionit.

Neni 9

Mandati i anëtarit të sapoemëruar të Komisionit zgjat deri në përfundim të mandatit të Komisionit.

Anëtarit të Komisionit i cili është shkarkuar para përfundimit të mandatit për të cilin është emëruar nuk mund të riemërohet anëtar i Komisionit.

Në rast të përfundimit të mandatit të anëtarit të Komisionit para përfundimit të mandatit për të cilin është emëruar, Kryetari i Komunës është i detyruar të emërojë një anëtar të ri të Komisionit brenda 15 ditëve nga data e përfundimit të mandatit.

VI – PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE PËR NDARJEN E MJETEVE

Neni 10

Mjetet e përcaktuara nga Buxheti i Komunës së Ulqinit shpërndahen për projektet që:

- inkurajojnë zhvillimin e shkrim-leximit dixhital të qytetarëve lokal të të gjitha moshave;
- inkurajojnë diversifikimin e aftësive të qytetarëve, veçanërisht personave jo të punësuar;
- inkurajojnë kulturën inovative të të rinjve;
- inkurajojnë ardhjen e nomadëve dixhital;
- inkurajojnë edukimin STEM;
- inkurajojnë zhvillimin e industrive krijuese (dmth. Aktivitete të bazuara në kreativitetin individual, aftësi dhe talente: zanatet, arkitektura, arti, dizajni, prodhimi, media, publikimi, zhvillimi i softuerit...);
- inkurajojnë zhvillimin e bizneseve fillestare (biznese teknologjike inovative që kanë potencial për rritje të shpejtë dhe shtrirje të madhe).

Neni 11

Projektet që nuk do të mbështeten janë:

- aktivitetet që janë nën juridiksionin ose përgjegjësinë e qeverisë, si edukimi formal, etj.;
- projektet që kërkojnë burime financiare për blerjen dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare;
- plan projektet që bazohen ekskluzivisht në krijimin, përgaditjen dhe shtypjen e njehershme të librave, broshurave, buletineve, revistave dhe të ngjashme, nëse botimit e tilla nuk janë pjesë e një programi më të gjërë ose aktiviteteve më gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme;
- aktivitetet që konsiderohen të paligjshme ose të dëmshme për mjedisin dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut.

VII – PROCEDURA E THIRRJES PUBLIKE

Neni 12

Aplikimi në thirren për plan të biznesit dorëzohet brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të tij.

Aplikimi i dorëzohet Komisionit në zyrën civile të Komunës së Ulqinit.

Kushtet më të hollësishme për pjesëmarrje në këto thirrje, kriteret e përzgjedhjes dhe detaje të tjera me rëndësi për realizimin e thirrjeve do të përcaktohen nga Komisioni dhe Sekretariati kompetent në përputhje me këtë vendim dhe rregulloret pozitive të Malit të Zi.

1. Verifikimi administrativ

Neni 13

Komisioni hap projektet e dorëzuara në kohë në zarfe të mbyllura në seancën e parë pas përfundimit të afatit të dorëzimit të aplikimeve dhe jo më vonë se 10 ditë nga afati për dorëzimin e aplikimeve.

Aplikimet e pakompletuara dhe të parakohshme do të refuzohen nga Komisioni me vendim.

2. Kriteret për shpërndarje

Neni 14

Një person (fizik ose juridik) mund të aplikojë me së shumti dy projekte dhe mund të mbështetet vetëm një plan i biznesit.

Neni 15

Komisioni bën shpërndarjen e mjeteve për projektet në bazë të kriterëve pozitive dhe eliminatore.

Lista përfundimtare e kriterëve pozitive përcaktohet nga Komisioni për çdo konkurs individualisht, ku duhet të përfshijë kriteret e detyrueshme pozitive të mëposhtme:

- 1) Lidhja e projektit me prioritetet e përcaktuara në nenin 10 të këtij vendimi;
- 2) Projekti të nxisë punësimin (të përhershëm ose sezonal) të personave nga territori i komunës së Ulqinit;
- 3) Aspekti inovativ i projektit;
- 4) Lidhja e projektit me aktivitetet e mëparshme të personit;
- 5) Përvoja e mëparshme e aplikantit.

Kriteret eliminatore janë:

- 1) Aplikimi i dorëzuar jashtë afatit kohor të Thirrjes publike;
- 2) Mungesa e kushteve formale për konkurimin e projektit (dokumentacioni i paplotë ose i pasaktë);

Formulari i vlerësimit të projektit i plotësuar nga Komisioni duhet të përmbajë:

- emrin e saktë të projektit;
- vlerësimi i projektit në numra, sipas shkallës së vlerësimit për secilën nga kriteret pozitive të përcaktuara me këtë vendim;
- tregues që projekti mbështetet në tërësi, ose një pjesë e projektit mbështetet, ose që projekti është refuzuar;
- shumën e fondeve të miratuara (në rast se projekti mbështetet tërësisht ose pjesërisht);
- sqarimin për refuzimin e projektit (në rast se mbështetja e projektit refuzohet);
- rubrika tjetër për opinione dhe shpjegime shtesë lidhur me projektin, të rëndësishme për vendimmarrjen e Komisionit vlerësimi i të cilave nuk është i paraparë me kriteret e përcaktuara.

3. Përcaktimi i listës së renditjes

Neni 16

Për vlerësimin e projekteve në bazë të kriterëve pozitive përdoret shkalla nga 1 deri në 5 pikë për secilin kriter individualisht, ku 1 pikë do të thotë "nuk përputhet fare me kërkesën" dhe 5 pikë do të thotë "përputhet plotësisht me kërkesën".

Secili anëtar i Komisionit vendos pikët për secilin nga kriteret pozitive.

Nota mesatare e pikëve për secilin kriter përfaqëson shumën e pikëve të të gjithë anëtarëve të Komisionit pjesëtuar me numrin e anëtarëve të Komisionit.

Nota përfundimtare e projektit përfaqëson shumën e notave mesatare për të gjitha kriteret.

Projektet me notë përfundimtare nën 25% të pikëve nuk do të mbështeten.

4. Vendimi për shpërndarjen e mjeteve

Neni 17

Komisioni merr Vendim për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK në Komunën e Ulqinit në bazë të renditjes së projekteve në përputhje me nenin 16 të këtij Vendimi.

Në rast se dy ose më shumë projekte marrin të njëjtin numër pikësh dhe mjetet në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për financimin e tyre, mjetet do të ndahen për planin e biznesit në bazë të vendimit të marrë me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Komisionit.

Neni 18

Komisioni është i detyruar të marrë Vendimin për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK në Komunën e Ulqinit brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së thirrjes.

Neni 19

Vendimi për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK në Komunën e Ulqinit duhet të përmbajë:

- emrin dhe mbiemrin e personit të cilit i janë miratuar mjetet, përkatësisht emrin e personit juridik dhe emri e mbiemri i personit përgjegjës;
- emrin e projektit për realizueshmërinë e të cilit janë miratuar mjetet;
- shumën e mjeteve të miratuara nga Komisioni për secilin nga projektet e biznesit respektivisht;
- shumën totale të mjeteve të nevojshme për realizimin e çdo projekti me të dhëna për të ardhurat e tjera të mundshme.

Vendimi për ndarjen e mjeteve u dërgohet personave të cilëve u janë ndarë mjetet.

Komisioni është i obliguar të informojë aplikantët për të gjithë projektet e refuzuara për arsyet e refuzimit.

Neni 20

Vendimi për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK në Komunën e Ulqinit u dërgohet pjesëmarrësve të thirrjes, publikohet në web faqen e Komunës, përmes transmetuesit publik lokal dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

VIII – FIRMOSJA E KONTRATËS

Neni 21

Pas miratimit të Vendimit për shpërndarjen e mjeteve për promovimin e komunitetit TIK në Komunën e Ulqinit dhe shpalljes së tij publike, Sekretariati kompetent me personat/personin përgjegjës në subjektet të cilave iu janë ndarë mjetet lidhin kontratë brenda 10 ditëve nga data e

miratimit të Vendimit me të cilën përcaktohen të drejtat dhe detyrimet reciproke, mënyra e shfrytëzimit të mjeteve, raportimi dhe mbikqyrja e zbatimit të projektit.

Ne afat prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit të kontratës, mjetet e ndara derdhen në llogarinë e personit juridik ose fizik në përputhje me kontratën nga paragrafi 1 i këtij neni.

Zbatimi i kontratës së lidhur monitorohet nga Komisioni.

IX – MONITORIMI I ZBATIMIT DHE VLERËSIMI I SUKSESIT TË PROJEKTEVE

Neni 22

Monitorimi i zbatimit të projektit kryhet nga Komisioni. Me qëllim të monitorimit të zbatimit të projekteve të mbështetura, në veçanti do të merret parasysh:

- Rrjedha e realizimit të aktiviteteve të planifikuara
- Realizimi i fondeve të shpërndara

X – RAPORTIMI I PROJEKTEVE TË REALIZUARA

Neni 23

Personat të cilët kanë përfituar mjete për projekte i dorëzojnë Komisionit një Raport mbi realizimin e projektit me pasqyrat financiare deri në fund të afatit të përcaktuar në Kontratë e më së shumti një vit nga ndarja e mjeteve.

Neni 24

Në rast të mos dorëzimit të Raportit brenda afatit të përcaktuar në Kontratë ose për shkak të keqpërdorimit të mjeteve, personi është i detyruar t'i kthejë mjetet e përfituara me kërkesë të Komisionit dhe Sekretariatit kompetent.

Neni 25

Me qëllim të informimit të opinionit të gjërë me projektet e realizuara, Komisioni në mënyrë të duhur mund të prezantojë publikisht aktivitetet e realizuara dhe rezultatet e realizuara të projekteve deri në shpalljen e thirrjes së re.

XI – RAPORTIMI I KUVENDIT

Neni 26

Sekretariati kompetent i paraqet Kuvendit Raportin për projektet e mbështetura, shumën e mjeteve të ndara, projektet e realizuara dhe efektet e tyre.

Raporti dorëzohet jo më vonë se në tremujorin e dytë të vitit pasardhës për vitin e kaluar.

XII – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 27

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Fletën Zyrtare të Malit të Zi – Rregullorja e komunave".

Numër:
Ulqin, _____

Kuvendi i Komunës së Ulqinit
Kryetarja e Kuvendit

Ivana Popović

Arsyetim

Baza ligjore për marrjen e këtij vendimi është përcaktuar në nenin 27 paragrafi 1 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. Zyrtare MZ", nr. 2/18 dhe 34/19) dhe neni 36 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Ulqinit, të cilat specifikojnë punët e komunës dhe masat që ajo zbaton për zhvillimin e degëve të caktuara, realizimin e të drejtave të qytetarëve dhe përmbushjen e interesave të qytetarëve.

Shkak për marrjen e këtij vendimi është fakti se Vendimi për buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2024 i parasheh këto mjete financiare.

PËRPUNUESI

Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik



Crna Gora / Mali i Zi
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT
Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj
Sekretariati për ekonomi dhe zhvillim ekonomik
Br. / Nr. 08-08224-1292/3
Ulcinj / Ulqin, 08.11.2024. god.vit

Na osnovu Zaključka Predsjednika Opštine, br. 01-040/24-1384/1 od 26.09.2024. godine Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj je objavio Program javne rasprave, na osnovu kojeg je sačinio:

IZVJEŠTAJ

o sprovedenoj javnoj raspravi u vezi sa Nacrtom Odluke o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT)

Predsjednik Opštine Ulcinj je Zaključkom br. 01-040/24-1384/1 od 26.09.2024. godine je utvrdio Nacrt Odluke o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT), i obavezao Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj da sprovede javnu raspravu u trajanju od 15 dana.

Programom javne rasprave o Nacrtu Odluke o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT) br. 08-082/24-1292/1 od 14.10.2024. godine je određeno da će javna rasprava trajati 15 dana, počev od 16.10.2024. godine zaključno sa 30.10.2024. godine.

Dana 16.10.2024. godine, Nacrt Odluke je objavljen na web stranici Opštine Ulcinj (www.ul-gov.me), a zainteresovani imali su mogućnost uvida u Nacrt Odluke u toku trajanja javne rasprave u prostorijama Sekretarijata za privredu i ekonomski razvoj Opštine Ulcinj (Adresa: Bul. Gj. K. Skenderbeu) u kancelariji br. 115 svakog ponedjeljka, srijede i petka u periodu od 11:00-13:00 časova.


Zainteresova javnost je imala mogućnost da sve primjedbe, predloge, sugestije i mišljenje dostave u pisanoj formi na adresu Opštine Ulcinj – Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj, preko Građanskog biroa Opštine Ulcinj ili u elektronskoj formi na email: ekonomi@ul-gov.me, do isteka roka za javnu raspravu. U navedenom periodu, nadležni Sekretarijat nije dobio nijednu primjedbu, predlog, sugestiju i mišljenje.

Centralna javna rasprava o utvrđenom Nacrtu Odluke održana je 28.10.2024. godine, sa početkom u 11:00 časova. Pristuni od strane Sekretarijata za privredu i ekonomski razvoj su bili Jetmir Muja

i Milada Kurti. Na javnoj raspravi nije bilo prisutnih građana ni predstavnika od drugih sekretarijata opštine. Javna rasprava je zatvoren u 12:00 časova.

Nacrta Odluke o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT) će biti upućen Ministarstvu finansije, radi dobijanja saglasnosti i mišljenje o Izveštaja analize procjene uticaja propisa za lokalne samouprave, a nakon toga i Skupštini Opštine Ulcinj na usvajanje.

SEKRETAR
Arbin Çapriqi



OBRAZAC

IZVJEŠTAJ O SPROVEDENOJ ANALIZI PROCJENE UTICAJA PROPISA ZA LOKALNE SAMOUPRAVE	
PREDLAGAČ PROPISA	Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj Opština Ulcinj
NAZIV PROPISA	Odluka o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT)
1. Definisanje problema	
<ul style="list-style-type: none"> • Da li je propis posljedica zahtjeva (propisa) na državnom nivou? • Navesti zakonski, odnosno strateški ili drugi osnov za donošenje propisa? • Da li se propisom utvrđuju sopstvene nadležnosti ili preneseni, odnosno povjereni poslovi lokalne samouprave? • Koje probleme treba da riješi predloženi akt? • Da li problem ima rodnu dimenziju? (ima posebni uticaj na žene) • Koji su uzroci problema? • Koje su posljedice problema? • Koji su subjekti oštećeni, na koji način i u kojoj mjeri? • Kako bi problem evoluirao bez promjene propisa? 	
<ul style="list-style-type: none"> • Donošenje ove Odluke nije posljedica zahtjeva propisa na državnom nivou. • Zakonski osnov za donošenje Odluke su član 27 stav 1 Zakona o lokalnoj samoupravi ("Sl. list CG", br. 2/18 i 34/19) i član 31 stav 1 Statuta Opštine Ulcinj • Ovom odlukom se ne može odstupiti od odredbi na državnom nivou. • Podsticaji i razvoj strateških grana ekonomije u opštini su sopstveni nadležnosti lokalne samouprave. • Problem koji treba da riješi ova Odluka je razvoj IKT sektora u teritoriji opštine Ulcinj. Problem nema rodnu dimenziju. • Uzroc problema su duboki, ali se uglavnom svodi na slabu digitalnu pismenost stanovnika, nedovoljne edukacije građana o mogućnostima i potencijalu koji IKT sektor ima. Cilj je da se dodijele sredstva institucijama, fizičkim licima, preduzecima i nevladinim organizacijama za podsticaj IKT. • Odlukom se definiše postupak raspodjele sredstava Budžeta opštine Ulcinj za ovu namjenu. • Posljedice problema su nedovoljno učešće mladih u globalnom tržištu rada na IKT sektoru te slabo korišćenje IKT servisa javne i lokalne administracije. • Oštećeni subjekti u sve institucije odnosno lica koja se bavi IKT iz razloga što ne postoji dovoljna raspodjela sredstava odnosno pomoć od strane opštine. Raspodjelom sredstava podstacice se novi projekti iz oblasti IKT. 	

- Bez donošenja ove odluke, podsticaj razvoja IKT sektora, tj. za modernizaciju društva bi bio nemoguć. Sa druge strane, bez podsticajnih mjera nezaposlenost bi ostao ključan problem odlaska mladih iz Ulcinja.

2. Ciljevi

- **Koji ciljevi se postižu predloženim propisom?**
- **Da li bilo koji od ciljeva unapređuje rodnu ravnopravnost?**

Odlukom se ostvaruje nekoliko ciljeva:

- Opisuje se postupak za raspodjelu sredstava za podsticaj IKT zajednice;
- Omogućuje realizaciju Odluke o budžetu;
- Omogućava se podrška IKT zajednici u opštini Ulcinj.

Projekti za koje će biti usmjeren novac, odnosice se na:

- razvoj digitalne pismenosti građana opštine svih dobi;
- diversifikaciju vještina građana, pogotovu nezaposlenih lica;
- podsticaj inovacionu kulturu mladih;
- dolazak digitalnih nomada;
- podsticaj STEM edukaciju;
- razvoj kreativnih industrija (tj. aktivnosti koje su bazirane na individualnoj kreativnosti, vještini i talentu: zanati, arhitektura, umjetnost, dizajn, produkcija, mediji, izdavaštvo, razvoj software-a...);
- razvoj start-up-ova (inovativnih tehnoloških biznisa koji imaju potencijal brzog rasta i velikih dometa).

Ciljevi koji se postižu predloženim propisom ne doprinose unaprijeđenju rodne ravnopravnosti.

3. Opcije

- **Zašto je propis neophodan?**
- **Koje su moguće opcije za ispunjavanje ciljeva i rješavanje problema? (uvijek treba razmatrati "status quo" opciju i preporučljivo je uključiti i neregulatornu opciju, osim ako postoji obaveza donošenja predloženog propisa).**
- **Obrazložiti preferiranu opciju? (prilikom obrazlaganja opcije uključiti i rodnu dimenziju te opcije: kako preferirana opcija unapređuje rodnu ravnopravnost-status žena i odnose među ženama i muškarcima)**

Propis je neophodan za podsticaj IKT zajednice. Bez donošenja ovog propisa bila bi onemogućena raspodjela sredstava. Kako bi svi zainteresovani mogli da iskoriste benefite neopodno je donijeti odluku kako bi iz budžeta bila opredijeljena sredstva za podsticaj IKT zajednce. Sa druge strane, neophodno je i formiranje Komisije za raspodjelu sredstava. Iz navedenog proizilazi da nije moguće razmatrati status quo opciju.

4. Analiza uticaja

- **Na koga će i kako će najvjerojatnije uticati rješenja u propisu - nabrojati pozitivne i negativne uticaje, direktne i indirektne, ,kao i rodno-senzitivne uticaje propisa?**

- Koje troškove će primjena propisa izazvati građanima i privredi (naročito malim i srednjim preduzećima)
- Da li pozitivne posljedice donošenja propisa opravdavaju troškove koje će on stvoriti?
- Da li se propisom podržava stvaranje novih privrednih subjekata na tržištu i tržišna konkurencija?
- Uključiti procjenu administrativnih opterećenja i biznis barijera.

Ova odluka ima samo pozitivan uticaj, i podstiče kreativnost i djelovanje lica (pravnih i fizičkih) iz IKT oblasti kroz digitalnu pismenost, diverzifikaciju vještina, inovacija, digitalne nomade, STEM edukacija, kreativne industrije i razvoj start-up-ova.

Podsticajem IKT zajednice se podstiče diversifikacija radnih vještina zainteresovanih lica koji mogu svoje usluge i znanja aplicirati online na globalnom digitalnom tržištu rada.

Projekti koji se mogu podržati, mogu kreirati nova radna mjesta, donijeti nove ideje i vrijednosti.

Primjena propisa neće izazvati troškove građanima i privredi, jer će opština finansirati odobrene projekte koji budu aplicirani od strane zainteresovanih strana.

U ovom trenutku, ne postoje barijere razvoje ove zajednice.

5. Procjena fiskalnog uticaja

- Da li je potrebno obezbjeđenje finansijskih sredstava iz budžeta lokalnih samouprava, odnosno budžeta Crne Gore za implementaciju propisa i u kom iznosu?
- Da li je obezbjeđenje finansijskih sredstava jednokratno, ili tokom određenog vremenskog perioda? Obrazložiti.
- Da li su neophodna finansijska sredstva obezbijedena u budžetu lokalnih samouprava, odnosno budžetu Crne Gore za tekuću fiskalnu godinu, odnosno da li su planirana u budžetu za narednu fiskalnu godinu?;
- Da li propis utiče na visinu prihoda jedinice lokalne samouprave, odnosno prihoda budžeta Crne Gore i kako?
- Da li će se implementacijom propisa ostvariti novi prihod za budžet jedinice lokalne samouprave odnosno za budžet Crne Gore?
- Ko su potencijalni korisnici budžeta za implementaciju propisa (u kojem procentu bi korisnici mogli biti muškarci, a u kojem žene? Da li implementacija budžeta može biti uzrok neravnopravnosti između muškaraca i žena?)

Propis ne utiče na visinu prihoda ili troškova lokalne samouprave.

Nije neophodno obezbjeđivanje dodatnih sredstava za implementaciju propisa. Odlukom o budžetu Opštine Ulcinj za 2024. godinu su već predviđena sredstva za ovu namjenu na poziciji 41842- Podrska i podsticaj IKT zajednice u iznosu od 15.000,00€.

Stvaranjem novih radnih mjesta i obučavanjem građana, mogu se podstići veći prihodi kreativne zajednice i time imati veće prilive u budžete.

Implementacija budžeta ne uzrokuje neravnopravnost između muškaraca i žena.

6. Konsultacije zainteresovanih strana

- Naznačiti da li je korišćena eksterna ekspertiza i ako da, kako?
- Naznačiti koje su grupe zainteresovanih strana konsultovane, u kojoj fazi RIA procesa i kako (javne ili ciljane konsultacije).
- Da li su predstavnice ženskih udruženja bile uključene u konsultacije?

- **Naznačiti glavne rezultate konsultacija, i koji su predlozi i sugestije zainteresovanih strana prihvaćeni odnosno nijesu prihvaćeni. Obrazložiti.**

Nacrt Odluke o kriterijumima, načinu i postupku raspodjele sredstava za podsticaj zajednice informaciono komunikacione tehnologije (IKT) bio je predmetom javne rasprave u trajanju od 15 dana, počev od 16.10.2024. godine zaključno sa 30.10.2024. godine. Program javne rasprave objavljen je na web stranici Opštine Ulcinj (www.ul-gov.me). Javna rasprava se održala u elektronskoj, pisanoj i usmenoj formi. Javna rasprava u elektronskoj formi se organizovala putem dostavljanja elektronskih primjedbi, predloga, sugestija i mišljenja građana i drugih učesnika na email ekonomi@ul-gov.me u toku cjelokupnog perioda predviđenog za javnu raspravu. Javna rasprava u pismenoj formi organizovana je putem dostavljanja pisanih primjedbi, predloga, sugestija i mišljenja građana i drugih učesnika na adresu: Opština Ulcinj – Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj, preko Građanskog biroa Opštine Ulcinj, zaključno sa danom okončanja javne rasprave. Takođe, zainteresovani subjekti su imali mogućnost uvida u Nacrt Odluke u toku trajanja javne rasprave u prostorijama Sekretarijata za privredu i ekonomski razvoj Opštine Ulcinj (Adresa: Bul. Gj. K. Skenderbeu) u kancelariji br. 115 svakog ponedjeljka, srijede i petka u periodu od 11:00-13:00 časova, do isteka roka za javnu raspravu. Centralna javna rasprava u usmenoj formi održana je 28.10.2024. godine, u 11:00 časova u maloj sali Skupštine Opštine Ulcinj. Pristuni od strane Sekretarijata za privredu i ekonomski razvoj su bili dva savjetnika. Na javnoj raspravi nije bilo prisutnih građana ni predstavnika od drugih sekretarijata opštine. Javna rasprava je zatvoren u 12:00 časova. Nakon sprovedenog postupka javne rasprave sačinjen je izvještaj o sprovedenoj javnoj raspravi.

7: Monitoring i evaluacija

- **Koje su potencijalne prepreke za implementaciju propisa?**
- **Koji su glavni indikatori prema kojima će se mjeriti ispunjenje ciljeva?**
- **Ko će biti zadužen za sprovođenje monitoringa i evaluacije primjene propisa?**

Ne očekuju se prepreke za implementaciju ove odluke osim u slučaju da ne bude zainteresovanih strana za apliciranje projekata.

Indikatori za ispunjenje ciljeva su otvaranje konkursa i raspodjela sredstava projektima, kao i izvještaj o realizovanim projektima kroz koji će se pratiti tok realizacije planiranih aktivnosti i realizacija dodijeljenih sredstava.

Sekretarijat za privredu i ekonomski razvoj u saradnji sa ostalim organima lokalne uprave će biti zadužena za sprovođenje monitoringa i evaluacije primjene propisa.

Datum i mjesto
Ulcinj, 18.10.2024. godine

SEKRETAR
Arbin Çapriqi

